REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

# VENDIM
# PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË LIPJAN

## Neni 1
## Përbërja

Me këtë Vendim, THEMELOHET, Këshilli Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara në Lipjan, në këtë përbërje:

1. Hasan Luma, Njësiti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, Kryesues i Këshillit
2. Linda Shahini, Zyrtare në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim, Zëvendeskryesuese e Këshillit,
3. Arjeta Thaqi Stublla, Shtëpia e komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore – ngecje në zhvillim mendor, anëtare
4. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
5. Afrim Mena OJQ- Handikos, anëtar
6. Fahrije LLugiqi, OJQ-OMPAKL, anëtare
7. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
8. Fadil Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
9. Lidija Jovanoviq, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
10. Venera Jashanica, Qendra për Punë Sociale, anëtare
11. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare

## Neni 2
## Detyrat dhe përgjegjësitë

Këshilli Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara ka për qëllim që të angazhohet për krijimin e mundësive të barabarta, përmirësimin e kushteve të jetës për personat me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit, punësimit, shërbimet ndihmëse dhe jetesës pa pengesa, parandalimin e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe procesit të krijimit të politikave të gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke përditësuar kulturën e respektimit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të personave me aftësi të kufizuara, dhe të sigurojë që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara të merren gjithmonë

parasysh dhe me prioritet, çdo herë kur Komuna e Lipjanit merr vendim për çështjet që mund të kenë ndikim në gjendjen e personave me aftësi të kufizuara.

Takimet e Këshillit i udhëheq Kryesuesia e Këshillit Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara e cekur në numrin rendor 1 e në rast të mungesës së saj do të udhëhiqen nga zëvendësuesi i kryesueses i cekur në numrin rendor 2.

**Neni 3**
**Zbatimi**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtorati për Administratë-Njësiti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore

**Neni 4**
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi pas nënëshkrimit nga Kryetari i Komunës me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.020/04-52794 i datës 30.09.2022.

1Nr.020/01-39160
Lipjan, më 08.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës, nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procoedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

**Neni 1**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit shëndetësor për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale QKMF – Dr. Mehdi Zejnullahu – Lipjan Nr.03.111/01-33766 i datës 15.07.2024, në këtë përbërje:

1. Izer Sinani, QKMF-Lipjan, Kryesues
2. Valdete Muji, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Besa Bislimi, Sektori për personel, anëtare

**Neni 2**

1. Detyrë e Komisionit të ankesave është shqyrtimi i ankesave për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale QKMF – Dr. Mehdi Zejnullahu – Lipjan Nr.03.111/01-33766 i datës 15.07.2024 dhe ka mandat të përkohshëm përkatësisht vlen vetëm për procedurat e konkursit të cekur.
2. Komisioni shqyrton ankesën dhe publikon rerezultatin përfundimtar brenda 5 (pesë) ditëve dhe për secilën ankesë nxjerr vendim në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procoedurave të konkursit në sektorin publik si dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/01-41668
Lipjan, më 20.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

## VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

### Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **8,960.00€,** (tetë mijë e nënëtqindë e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-37922 e datës 02.08.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 32 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin korrik të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast 32 x 280 = 8,960.00€, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

### Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-37922
Lipjan, më 05.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Rregullores (QRK) - Nr.23/2023 për Procedurat e Punës në Tryezat Multidisiplinare për ndihmë në Menaxhimin e Rastit si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr:

# VENDIM
# PËR THEMELIMIN E TRYEZES MULTIDISIPLINARE NË KOMUNËN E LIPJANIT

## Neni 1
## Përbërja

1. Me këtë Vendim themelohet tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit, në përbërje si vijon:

1.1 Menaxheri i rastit, Qendra për Punë Sociale,
1.2 Ndihmës menaxheri rastit, Qendra për Punë Sociale,
1.3 Përfaqësues nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave,
1.4 Përfaqësuese nga Shërbimi Sprovues i Kosovës,
1.5 Qendra e Mjekësisë Familjare, Mjekë specialist sipas rasteve specifike,
1.6 Përfaqësues nga Policia e Kosovës,
1.7 Përfaqësues nga Qendra për Shëndetin Mendor-Specialist i fushës për trajtimin e fëmijëve,
1.8 Zyrtar/e për Arsim, Drejtorati për Arsim Komuna e Lipjanit,
1.9 Zyrtar/e nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i Komunës së Lipjanit,
1.10 Psikolog, Puntor social, Pedagog i shkollës ose përfaqësues i deleguar nga Institucionet Edukativo - Arsimor,
1.11 Zyrtar/e nga Zyra Komunale për Komunitete nga Komuna e Lipjanit
1.12 Përfaqësues nga Institucioni për Strehim Përkujdesës ose familja strehuese,
1.13 Zyrtar/e nga Njësiti për të Drejta të Njeriut dhe Barazi Gjinore nga Komuna e Lipjanit dhe
1.14 Përfaqësues nga Organizatat Joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni në rastet kur fëmija është azilkërkues, pa-shtetësi, refugjat apo migrant, përbërjes së Tryezës, duhet t'i shtohen edhe përfaqësues tjerë relevantë ashtu siq parashihet me nenin 6 paragrafi 6.1 i Rregullores (QRK) - Nr.23/2023 për Procedurat e Punës në Tryezat Multidisiplinare për ndihmë në Menaxhimin e Rastit.

## Neni 2
## Detyrat dhe përgjegjësitë e Tryezës Multidisiplinare

1. Tryeza Multidisiplinare nën udhëheqjen e menaxherit të rastit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1.1. Trajton rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore në bazë të interesit më të mirë të fëmijës.
1.2. Përcjell dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e rastit të bërë paraprakisht nga menaxheri i rastit, duke e plotësuar me informata të përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave në rast.

1.3. Bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës në përputhje me rrethanat dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;
1.4. Koordinon ofrimin e shërbimeve për mbrojtje, rehabilitim, dhe integrim apo riintegrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrah familjet e tyre ose kujdestarin;
1.5. Rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike edhe më shpesh.
1.6. Harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton tek Komuna dhe sipas kërkesës edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës.
2. Tryeza Multidisiplinare mbyll rastin kur vlerësohet se të gjitha shërbimet e nevojshme janë ofruar dhe është ulur niveli i rrezikut apo nuk ka rrezik për mirëqenien e fëmijës.

3. Tryeza Multidisiplinare detyrat e tjera do t'i kryen duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Rregullores (QRK) – Nr.23/2023 për Procedurat e Punës në Tryezat Multidisiplinare për ndihmë në Menaxhimin e Rastit si dhe akteve tjera ligjore përkatëse.

**Neni 3**
**Hryja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet DSHPS-ja, QPS-ja në Lipjan, dhe Institucionet e tjera të përfshira në këtë Vendim.

1Nr. 183/01-43424
Lipjan, më 28.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, nenit 16 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenti 2 paragrafi 9 nënparagrafi 9.1 i Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024 si dhe kërkesës së Sektorit për çështje pronësoro-juridike Nr.1-400/04-41244 të datës 19.08.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

**VENDIM**
**PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

Më këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **62,910.00 €** (gjashtëdhjetë e dymijë e nëntëqind e dhjetë euro) në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme si dhe Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024, certifikata - njësia kadastrale 0-71409044-01747-0-46-1-4-0, 0-71409044-01747-0-46-1-I-0 ZK Lipjan pronari Xhevdet Sadiku.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të trasferohet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor Infrastruktura rrugore 18003, për projektin ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkut nëntokësor sipas kodit 52996 në xhirollogarinë bankare të Mirëbesimit në Bankën Qendrore të Kosovë (BQK) në nr. 1000400070010268.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit – Sektori për Çështje Pronësore Juridike.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njejtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori për Çështje Pronësore Juridike

1Nr. 400/04-41244/5
Lipjan, më 19.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, nenit 16 i Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenti 2 paragrafi 9 nënparagrafi 9.1 i Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 29.03.2023 si dhe kërkesës së Sektorit për çështje pronësoro-juridike Nr.1-400/04-41244 të datës 19.08.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

## VENDIM
## PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1
Më këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **35,340.00 €** (tridhjetë e pesëmijë e treqind e katërdhjetë euro) në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme si dhe Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 29.03.2023, certifikata - njësia kadastrale 0-71409044-01747-046-I-7 ZK Lipjan pronare Rahmete Emini.

### Neni 2
Shuma e cekur nga neni 1 do të trasferohet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor Infrastruktura rrugore 18003, për projektin ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkut nëntokësor sipas kodit 52996 në xhirollogarinë bankare të Mirëbesimit në Bankën Qendrore të Kosovë (BQK) në nr. 1000400070010268.

### Neni 3
Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit – Sektori për Çështje Pronësore Juridike.

### Neni 4
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njejtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori për Çështje Pronësore Juridike

1Nr. 400/04-41244/6
Lipjan, më 19.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, nenit 16 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenti 2 paragrafi 9 nënparagrafi 9.1 i Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024 si dhe kërkesës së Sektorit për çështje pronësoro-juridike Nr.1-400/04-41244 të datës 19.08.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

**VENDIM**
**PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

Më këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **65,520.00 €** (gjashtëdhjetë e pesëmijë e peseqind e njëzetë euro) në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme si dhe Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024, certifikata - njësia kadastrale 0-71409044-01747-0-46-1-1-0 ZK Lipjan pronare Rufije Sadiku.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të trasferohet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor Infrastruktura rrugore 18003, për projektin ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkut nëntokësor sipas kodit 52996 në xhirollogarinë bankare të Mirëbesimit në Bankën Qendrore të Kosovë (BQK) në nr. 1000400070010268.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit – Sektori për Çështje Pronësore Juridike.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njejtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori për Çështje Pronësore Juridike

1Nr. 400/04-41244/2
Lipjan, më 19.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, nenit 16 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenti 2 paragrafi 9 nënparagrafi 9.1 i Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024 si dhe kërkesës së Sektorit për çështje pronësoro-juridike Nr.1-400/04-41244 të datës 19.08.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

**VENDIM**
**PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

Më këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **52,920.00 €** (pesëdhjetë e dymijë e nënteqind e njëzet euro) në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme si dhe Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024, certifikata – njësia kadastrale 0-71409044-01747-0-46-1-2-0 ZK Lipjan pronari Sami Krasniqi.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të trasferohet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor Infrastruktura rrugore 18003, për projektin ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkut nëntokësor sipas kodit 52996 në xhirollogarinë bankare të Mirëbesimit në Bankën Qendrore të Kosovë (BQK) në nr. 1000400070010268.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit – Sektori për Çështje Pronësore Juridike.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njejtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori për Çështje Pronësore Juridike

1Nr. 400/04-41244/3
Lipjan, më 19.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, nenit 16 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenti 2 paragrafi 9 nënparagrafi 9.1 i Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024 si dhe kërkesës së Sektorit për çështje pronësoro-juridike Nr.1-400/04-41244 të datës 19.08.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

# VENDIM
# PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

## Neni 1

Më këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **43,875.00 €** (katërdhjetë e tremijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë euro) në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme si dhe Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024, certifikata - njësia kadastrale 0-71409044-01747-0-46-1-5-0 ZK Lipjan pronare Xhevahire Salihu.

## Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të trasferohet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor Infrastruktura rrugore 18003, për projektin ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkut nëntokësor sipas kodit 52996 në xhirollogarinë bankare të Mirëbesimit në Bankën Qendrore të Kosovë (BQK) në nr. 1000400070010268.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit – Sektori për Çështje Pronësore Juridike.

## Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njejtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori për Çështje Pronësore Juridike

1Nr. 400/04-41244/4
Lipjan, më 19.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, nenit 16 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenti 2 paragrafi 9 nënparagrafi 9.1 i Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024 si dhe kërkesës së Sektorit për çështje pronësoro-juridike Nr.1-400/04-41244 të datës 19.08.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

**VENDIM**
**PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

Më këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **84,884.00 €** (tetëdhjetë e katërmijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër euro) në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme si dhe Vendimit Përfundimtar 01Nr.464/01-53706 të datës 13.06.2024, certifikata - njësia kadastrale 0-71409044-01747-3-46-1-3-0, 0-71409044-01747-3-46-1-4-0, 0-71409044-01747-3-46-1-II-0 ZK Lipjan pronare Ramize Zejnullahu.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të trasferohet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor Infrastruktura rrugore 18003, për projektin ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkut nëntokësor sipas kodit 52996 në xhirollogarinë bankare të Mirëbesimit në Bankën Qendrore të Kosovë (BQK) në nr. 1000400070010268.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit – Sektori për Çështje Pronësore Juridike.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njejtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori për Çështje Pronësore Juridike

1Nr. 400/04-41244
Lipjan, më 19.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-016/01-42589 të datës 23.08.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW), Kryetari i Komunes, nxjerr:

# VENDIM
# PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

## Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **1,500.00 €** (një mijë e pesëqind euro), për të vepruar konfrom Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-016/01-42589 të datës 23.08.2024 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) për realizimin e projektit "Çanta shkollore për fëmijët jetim" në Komunën e Lipjanit, ku sipas Marrëveshjes shuma e përgjithshme është 3,500.00 euro ndërsa Komuna e Lipjanti është e obliguar të participon në shumën prej 1,500.00 euro.

## Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, kategoria ekonomike - mallra dhe shërbime të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në xhirollogarinë bankare nr 1708200008014285 në NLB Banka të Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW).

## Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

1Nr. 400/01-42713
Lipjan, më 26.08.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
LIPJAN
OPŠTINA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSOVO